REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:254352
Datë: 28.07.2020
Numri i dokumentit: 01041561

V.EK.nr.573/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjykatësin Faton Bajrami, duke vendosur në çështjen juridike të paditësES, "Emona" sh.p.k. me seli në Vushtrri, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Qëndrim Zogaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës "Emona Center" sh.p.k., me seli në magjistralen Mitrovicë- Prishtinë, të cilën e përfaqëson, Merita Oshlani sipas autorizimit, baza juridike e kontestit – shkelje e markës tregtare, vlera e kontestit e pa përcaktuar, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur të datës datën 10.07.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses "Emona" sh.p.k. me seli në Vushtrri, ashtu që:

I. VËRTETOHET se e paditura "Emona Center" sh.p.k., me seli në magjistralen Mitrovicë- Prishtinë, me vendosjen në qarkullim të lirë të produktit çaj i zi "ceylon" me emrin "Emona Brand" me figurën e Zogut, ka shkelur markën tregtare "Emona Brand" me figurën e zogut të paditëses, të regjistruar me vendimin e lëshuar nga API me nr. regj.12629 të datës 25.03.2014.

II. OBLIGOHET e paditura "Emona Center" sh.p.k., që të ndërprenë vendosjen e mëtutjeshme në qarkullim të lirë të produktit çaj i zi ceylon me emrin "Emona Brand" me figurën e Zogut dhe atë në paketimet 400g dhe 800g, si dhe çfarëdo sasie tjetër, e të cilat përbëjnë shkelje të markës tregtare të paditëses "Emona Brand" me figurën e zogut me nr.regj.12629 të datës 25.03.2014.

III. OBLIGOHET e paditura që të bëjë largimin nga tregu të të gjithë produktit të çajit të zi "ceylon" që përbëjnë markën tregtare të regjistruar të paditëses me nr.regj.12629 "Emona Brand" me figurën e zogut në sasitë 400g dhe 800g dhe çfarëdo sasie tjetër e cila gjendet në treg në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi.

IV. OBLIGOHET e paditura "Emona Center" sh.p.k., që të bëjë shpalljen publike të këtij aktgjykimi në gazetën "KOHA DITORE".

V. DETYROHET pala e paditur qe te ia kompensoj paditëses shpenzimet e procedurës në shumën prej 1,388.00 €.

A r s y e t i m i

Paditësja, "Emona" sh.p.k. me seli në Vushtrri, përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës "Emona Center" sh.p.k., me seli në magjistralen Mitrovicë- Prishtinë, për shkelje të markës tregtare.

Në padi dhe gjatë seancave gjyqësore të mbajtura ndër të tjera ka theksuar se paditësi është kompani e regjistruar në ARBK, ku si veprimtari kryesore ka tregtinë me shumicë të çajit, kafesë, kakaos dhe erëzave dhe se po konsumatorët njihet me produktet saj të çajit të zi "ceylon", të cilat produkte mbajnë markat e saj të mbrojtura tregtare të regjistruara në Agjencinë për pronësi Intelektuale në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Si një nga markat tregtare më të veçanta të paditësit me të cilat është i njohur për konsumatorët e zakonshëm për produktet e tij të çajit të zi ceylon është marka tregtare "Emona Brand" me figurën e Zogut e cila është e regjistruar me vendimin nr.regj. 12629 të datës 25.03.2014, për klasat 29, 30 dhe 35 sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Nicës. Ka theksuar, se është informuar përmes agjentëve të saj të shitjes se e paditura është duke vënë në qarkullim të lirë produktet e tij të çajit të zi "ceylon", duke përdorur pa autorizim markën tregtare të paditëses "Emona Brand" me figurën e Zogut, e që produkti i të paditurës të çajit të zi ceylon është identik me markën tregtare "Emona Brand" me shenjën e zogut të paditëses. Ngjashmëria mes markës tregtare të paditëses me të paditurën konsiston në ngjashmëri vizuale, konceptuale dhe aureale (dëgjimore), kjo përbën edhe një fakt më shumë që konsumatori i zakonshëm të hutohet/ vihet në lajthim me rastin e blerjes së këtyre produkteve. I ka dorëzuar gjykatës vendimin me nr. KS-2018-11085 me të cilin është bërë vazhdimi i vlefshmërisë së markës tregtare ku vlefshmëria e markës është zgjatë deri me datë 03.12.2028. E ka precizuar kërkesëpadinë ashtu që e ka tërheqë kërkesën për kompensimin e dëmit. andaj konsideron se kërkesëpadia duhet aprovohet në tërësi si e bazuar, e paditura të ndërprenë vendosjen e mëtutjeshme në qarkullim të lirë të produktit çaj i zi "ceylon" me emrin "Emona Brand" me figurën e zogut dhe atë në paketimet 400g dhe 800g si dhe çfarëdo sasie tjetër dhe ti largoj nga tregu produktet me markën e mbrojtur të paditëses.

E paditura, me përgjigjje në padi dhe gjatë seancave dëgjimore ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse, si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. E ka njoftuar gjykatën se ka qenë në raport kontraktual me pronarin e vërtet të markës së pretenduar të mbrojtur tregtare, kompania A.F. Jones exportes ceylon (private) limited me seli në Shrilank, nga e cila ka importuar çajin ku në bazë të këtij raporti kontraktual kanë vendosur shenjën e zogut si brend në paketimet e çajit. Ka shtuar se raportin e tyre kontraktual mund ta argumentojnë përmes DUD-ave doganor të realizuar gjatë vitit 2018, e po ashtu vendimi në bazë të cilit paditësja pretendon se e paditura ka shkelur markën tregtare është shfuqizuar me datë 29.09.2015, nga Agjencia e Pronësisë Industriale me kërkesë të pronarit të markës tregtare. Ka theksuar se në veprimet e të paditurës nuk ka elemente se i është shkaktuar dëm dhe ne si palë e paditur nuk kemi bërë shkelje të markës tregtare siç pretendon paditësi, andaj mbi këtë bazë i propozoi gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Paditësja, në fjalën përfundimtare, përmes të autorizuarit së saj, ka deklaruar se konsideron se nga provat e administruara vërtetohet fakti se e paditura ende është duke e shkelur markën tregtare të paditëses duke plasur respektivisht mos larguar produktet e saj që përbëjnë shkelje të markës tregtare nga tregu i Republikës së Kosovës. Se produktet e të paditurës gjenden ende në treg dëshmohen përmes kuponëve fiskal të dorëzuara e përmes tyre dëshmohen edhe vendet se ku ndodhen produktet e të paditurës. Provat e dorëzuara nga e paditura si DUD-at dhe emailat nuk dëshmojnë se produktet nuk janë duke u shitur, për faktin se të njëjtat mund të qëndroj në stog dhe kohë pas kohe të shpërndahet në treg. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë e precizuar të paditëses. Ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura, në fjalën përfundimtare, përmes të autorizuarës së saj, ka deklaruar se qëndrojnë pranë deklarimeve të më hershme dhe në tërësi i kundërshton thëniet dhe provat e dorëzuara nga pala paditëse për arsye se nuk kanë lidhshmëri dhe nuk vërtetojnë shkelje nga pala e paditur. Deklarimet e paditëses lidhur me atë se çaji i importuar mund të mbetët në stoqe dhe ta shesim në treg herë pas here nuk qëndron për arsye se që nga momenti i marrjes së njoftimit nga API për fuqizim të markës tregtare nga paditësi nëpërmjet faturave të kthimit si dokument i besueshëm dëshmojmë se i kemi ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për respekcim të vendimit dhe kthim të mallit. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Për të vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen faktike dhe besueshmërinë e kërkesëpadisë gjykata ka bërë administrimin e provave të lëndës përmes shikimit dhe leximit të tyre si në vijim: Vendimi i lëshuar nga MTI-API nr.12629 i datës 25.03.2014; vendimi për shfuqizimin e markës tregtare nr.01/VSH datë 29.05.2015; vendimi MTI-API i datës 17.08.2018; vendimi MTI-API 05.12.2018; shiqimi në kuponët fiskal të datës 17.06.2020 dhe i datës 04.02.2020; me shiqimin në marrëveshjen e datës 01 mars 2010, të arritur në mes të A.F. Jons exporters Ceilon dhe Agron Mikullovci dhe Emona Center sh.p.k.; shiqimi në DUD-a të ndryshëm; komunikimi me email i të paditurës me klient të ndryshëm, shiqimi në faturat për kthim të mallit (çajit).

Pas shqyrtimit dhe çmuarjes me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, dhe konstatimit të fakteve jo kontestuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

-Nga vendimi i lëshuar nga MTI me nr.12629 i datës 25.03.2014, është vërtetuar se paditësja e ka të mbrojtur markën tregtare "EMONA BRAND" me shenjën e zogut, për produktet dhe shërbimet Klasa 29 Mish, peshk, shpezë dhe mish gjahu; përpunime të mishit; fruta dhe perime të konservuara, thara dhe të ziera; pelte, reçelra dhe komposto; vezë, qumësht dh prodhime të qumështit; yndyrëra ushqimore dhe vajr, klasa 30 kafe, caj, kakao, sheqer, oriz, tapioca,sago, zavendsim për kafe; miel dhe produkte nga drithërat, bukë, akullore, mjaltë, melasë, tharm, pluhur për pjekje, kripë, mustarde; uthull molle, salca të ndryshme, erëza; akull, dhe klasa 35 Reklame; menaxhim biznesi; administrim biznesi; funksione zyre; menaxhim biznesi dhe konsultim; shërbime të menaxhimit të operacioneve për shpërndarjen e prodhimeve; shërbime të shitjes me pakicë.

-Nga vendimi me numër 01/VSH i datës 29.09.2015, i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, gjykata vërtetoi faktin se me këtë vendim është shfuqizuar marka tregtare e regjistruar e paditëses.

-Nga vendimi i MTI-API-së i datës 17.08.2018, është vërtetuar fakti se është shfuqizuar në tërësi Vendimi për shfuqizim i Agjencisë për Pronësi Industriale me nr.1/VSH i datës 29.09.2015, dhe ka mbetur në fuqi Vendimi për Regjistrimin e Markës Tregtare të paditëses, i Agjencisë për Pronësi Industriale me nr.12629 i datës 25.03.2014.

-Nga vendimi MTI-API-së i datës 05.12.2018, është vërtetuar fakti se është vazhduar regjistrimi i Markës Tregtare me nr.12629 e paditëses deri me datën 03.12.2028.

- Nga shikimi në kuponët fiskal të datës 17.06.2020 dhe të datës 04.02.2020, është vërtetuar fakti se produktet e të paditurës në të cilat përdoret marka tregtare e mbrojtur e paditëses gjenden ende në treg.

- Nga shikimi në marrëveshjen e datës 01 mars 2010, të arritur në mes të A.F. Jons Exporters Ceylon dhe Agron Mikullovci (kompania merret me eksportin e çajit të Sri Lankës) dhe Emona Center sh.p.k., është vërtetuar fakti se e paditura me të lartcekurin ka pasur marrëveshje me të cilën të paditurën e ka emëruar për promovimin e shitjes dhe reklamimit të produkteve të çajit nën "MARKËN EMONA", "EMONA CENTER" DHE "SHENJËN E ZOGUT TË KANARINËS", markë tregtare në Kosovë dhe Maqedoni dhe në cdo shtet tjetër për të cilat arrijnë marrëveshje me shkrim kohë pas kohe.

- Nga shikimi në DUD-a të ndryshëm, është vërtetuar fakti e paditura me A.F. Jons Exporters Ceylon dhe Agron Mikullovci (kompania merret me eksportin e çajit të Sri Lankës) në vitin 2018 kanë qenë në raport kontraktual.

-Nga komunikimin me email i të paditurës me klient të ndryshëm, vërtetohet fakti e paditura ka komunikuar me disa nga pikat e shitjes nga të cilat ka kërkuar largimin e produkteve me shenjën e zogut dhe ndërrimin e tyre.

- Nga shikimi në faturat për kthim të mallit (çajit), vërtetohet fakti se e paditura ka tërhequr mallin (çajin) nga disa pika të shitjes.

-Çështje relevante dhe po ashtu kontestuese në mes të palëve në procedurë, ka qenë ajo se mallrat e vëna në qarkullim të lirë të produkteve të çajit të zi "ceylon", duke përdorur pa autorizim markën tregtare të paditëses "Emona Brand" me figurën e Zogut nga e paditura, a e shkelin markën tregtare EMONA BRAND me figurën e zogut.

Fillimisht gjykata thekson se marka tregtare si institucion juridik-tregtar dhe mbrojtja e saj në territorin e Republikës së Kosovës, është e rregulluar me Ligjin për Markat Tregtare (LMT), si ligj bazë, të shpallur në G.Z të Republikës së Kosovës, nr. 10/24, të vitit 2011. Me nenin 5 të LMT janë përcaktuar shenjat që mund të mbrohen si markë tregtare, ku është përcaktuar si në vijim: "Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë e cila mund të paraqitet grafikisht, në veçanti fjalët, përfshirë edhe emrat personal, skicimet, shkronjat, numrat, formën e mallrave apo paketimin e tyre, ngjyrat si dhe kombinimi i gjitha këtyre me kusht që shenjat e tilla të mund të dallojnë mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga mallrat ose shërbimet e ndërmarrjeve tjera". Pastaj me nenin 8 të LMT-së, është përcaktuar:

1. Marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtën të ndalojë palët e treta të përdorin pa lejen e tij:

1.1. çdo shenjë, që është identike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare;

1.2. çdo shenjë që është identike ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e asocijimit së shenjës me markën tregtare;

1.3. çdo shenjë, që është identike apo e ngjashme me markën tregtare për produktet dhe shërbime të ndryshme nga ato për të cilat është regjistruar marka tregtare, kur kjo e fundit ka reputacion në Republikën e Kosovës dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i njohur i markës.

2. Sipas paragrafit 1. të këtij neni, pronari i markës gjithashtu mund të ndalojë këto veprime:

2.1. vendosja e shenjës në mallra apo në paketimet e tyre;

2.2. hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje dhe ofrimi i shërbimeve duke përdorur këtë shenjë, ose magazinimi i tyre për këto qëllime;

2.3. përdorimi i shenjës gjatë importimit apo eksportimit të mallrave;

2.4. përdorimi i shenjës në shkresa zyrtare dhe në reklamim.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave, kjo gjykatë gjeti se e paditura përmes vënies në qarkullim të lirë të produktit të cajit të zi ceylon me shenjën "Emona Brand" me figurën e zogut, ka shkelur markën tregtare të paditëses të mbrojtur me ligj. Deri në këtë konstatim gjykata erdhi pasi që nga vendimi i MTI- së për regjistrimin e markës tregtare paditësja është e vetmja e autorizuar për Republikën e Kosovës për përdorimin markës tregtare me shenjën "Emona Brand" me shenjën e zogut, andaj përdorimi i kësaj marke nga kushdo tjetër për të vënë mallra në qarkullim, paketim, hedhjen e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, importim, eksportim, shkresa zyrtare , reklamim etj., veprime të cilat shkelin të drejtën e markës tregtare të regjistruar. Sipas nenit 8 të Ligjit për Markat Tregtare, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullari i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit ose të ngjashme. Thelbi qëndron në funksionimin themelor të markës – identifikimit të origjinës së produktit apo shërbimit. Me nenin 96 të LMT-së është përcaktuar se: Pronari i markës tregtare mund të parashtrojë padi në gjykatë për konstatimin e shkeljes së të drejtës se markës tregtare kundër personit i cili ka shkelur të drejtën e markës duke kryer pa autorizim njërën nga veprimet e cekura në nenin 8 të këtij Ligji.

Edhe me këtë rast gjykata konsideron se legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës, nuk ja ndalon importimin e produkteve importuesit në Kosovë, kur këto produkte e kanë markën e tyre të regjistruar, por paraprakisht duhet që nga pronari i markës tregtare importuesi duhet t'u merr pëlqimin, gjegjësisht autorizimin për importimin e këtyre produkteve që marka e tyre tregtare është e mbrojtur me regjistrim të API-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, sipas të cilit: "Pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare dhe ndërhyrësit të saj, të ja kompensoj shpenzimet gjyqësore". Në rastin konkret shpenzimet gjyqësore si detyrim i të paditurës, përfshinë shumën prej 1,388.00 € dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumën prej 208 €, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 100.00 € dhe në emër të përfaqësimit te avokatit për katër seanca 270.00 € (4x270= 1,080.00€).

Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe konform dispozitave ligjore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE Në PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
V.EK.nr.573/2018, me datën 10.07.2020

Gjykatësi
Faton Bajrami

KESHILLE JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të tij.